



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 47

Datë: 03.11.2020. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Artan Asllani, Rifat Krasniq.

SKQZ: Burmi Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Ylli Buleshkaj, drejtor.

Përkthyese: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.42,43,44 dhe 45/2020.

2. Aktivitetet e SKQZ-së

3. Aktivitetet e ZRPPC-së

- Shqyrtimi i rekomandimit për certifikimin e kandidateve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së veriut, që do të mbahen më 29 nëntor 2020.

4. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Çështje ligjore;**

- Shqyrtimi i Udhëzimit për Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) dhe Këshillat e Vendvotimeve (KVV) të cilat merren me organizimin dhe me implementimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së veriut, që ditën e zgjedhjeve, me 29 nëntor 2020, t`i pranojë në vendvotim dokumentet e identifikimit të votuesve.

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Modernizimin e QNR-së ,
- Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit Operacional të Sigurisë i KQZ-së, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë dhe në Mitrovicë të Veriut,

5. Shqyrtimi i kërkesës të Sekretariatit të KQZ-së, për furnizimin me (600) Uv Sprej nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë dhe Mitrovicën e Veriut, që do mbahen do të mbahen më 29.10.2020

6. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.42,43,44 dhe 45/2020.

Valdete Daka: A ka dikush vërejtje në rendin e ditës ?

Arianit Elshani: S'i pikë të jetë shqyrtimi i raportit të Informimit Publik...

Alim Rama: Në mbledhjen e kaluar kemi kërkuar raportin mbi shfrytëzimin e automjeteve në bazë të rregullimit administrativ dhe, raportit të auditorit por, ende nuk ka ardhur... Kërkoj që ai raport të sillet dhe të shqyrtohet në mbledhje...!

Sami Hamiti: Është e vërtetë që këtë raport e kemi trajtuar në këshillin për buxhet, raportin e shpenzimit të veturave. Megjithatë, ne kemi kërkuar specifikim të shpenzimit. Me korrektesi, dua të them se ky raport ka dalë në media i pa specifikuar. Dalin emrat qe i shfrytëzojnë veturat, prandaj është më mirë që raporti të sillet këtu, dhe ne ta shqyrtojmë ne... Thuhet që ekskluzivisht e këtij është kjo veturë...! Edhe unë jam i autorizuar, por vetura shfrytëzohet edhe nga Sekretariati...

Valdete Daka: Po, është më mirë që raporti të sillet dhe të mos carkullojë në opinion me dezinformata. Sugjeroj për Sekretariatin të na sillet raporti i specifikuar... Kemi nevojë me ba transparente çdo shfrytëzim....

Me pikën s'i e gjashtë që u propozua për Informimin Publik, kush është për këtë rend dite...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së me vërejtjet e z. Rama dhe Vishi, miratuan procesverbalet nga mbledhjet nr. 42,43,44 dhe 45/2020.

2.Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj: Sekretariati, ju informoj se është duke punuar rreth raportit të shpenzimit të veturave, dhe posa të jetë gati, do ta sjellim në mbledhje. Në anën tjetër, janë duke u bërë përgatitjet me intensitet përgatitjet për zgjedhje në Podujevë dhe Mitrovicën e veriut. Aktivitetet janë: më datën 30 tetor, ka filluar periudha e shërbimit votues për ndërrimin e qendrave të votimit, dhe paralelisht, ka filluar periudha për aplikim e shërbimit të votuesve jashtë Kosovës. Këto dy aktivitete, janë në proces e sipër.

Programi orientues është mbajtur në zyrat e KQZ-së, dhe kanë marrë pjesë në trajnim 9 anëtarë të Komisionit komunal të zgjedhjeve në Mitrovicën e veriut. Kemi dërguar letër IKSHP, me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve. Dhe e kemi dërguar edhe dërguar edhe letrën e dytë që lidhet me votuesit e ngujuar që mund të infektohen nga covid-19, para procesit zgjedhor s'i do të mund të veprojmë në këto raste. Por, ende nuk kemi ndonjë përgjigje nga ministria e shëndetësisë, përkatësisht nga instituti dhe jemi në pritje të përgjigjes me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve për organizim të zgjedhjeve.

Vlen të theksohet, tha më tej z. Ahmetaj se, të gjitha aktivitetet kanë efekt dhe duhet të përbahen në bazë të rregullave të cilat i përcakton instituti. Sa i përket personave të ngujuar, Sekretariati i ka analizuar edhe shtetet e rajonit se si janë organizuar në kushte pandemie. Po ashtu, kemi marrë edhe një input dhe analizim nga shtete e rajonit, përkatësisht nga Republika e Maqedonisë së veriut për personat e ngujuar në shtëpi. Organizimi i zgjedhjeve në Maqedoninë e veriut, është bërë sepse ekipet mobile të cilat janë dërguar për të marr votat nga votuesit e ngujuar, zakonisht kanë qenë nga instituti, përkatësisht nga qendrat medicinale të cilat edhe ne mendojmë që të janë të shoqëruar nga ekipet mobile. Pra, edhe e mendojm që këtë formë ta organizojmë, por sidoqoftë jemi në pritje të institutit për të na i dhënë udhëzimet dhe rekomandimet në mënyrë që aktivitete të janë në mënyrë të bashkërenduar për anitcovid.

Sekretariati ka pranuar edhe buxhetin e miratuar nga qeveria dhe kemi filluar të gjitha procedurat e prokurimit për blerjen e produkteve të cilat, do të përdoren në procesin e zgjedhjeve dhe jemi në fazën e shpalljes së tenderëve për prokurimin e tyre. Deri më tanë, nuk kemi ndonjë pengesë përpos furnizimit me ujë dhe sprej. Sekretariati, ka bërë shpalljen publike me kohë dhe ka ftuar operatorët e ndryshëm për tu përgjigjur ftesës për tender të cilët, tre operator janë përgjigjur mirëpo, në bazë të specifikave nuk ka rezultuar asnjëri nga operatorët i suksesshëm. Tani, nuk na premton më koha sepse, sprej ultra violet është i veçantë dhe nuk mund të prodhohet në Kosovë.

Sekretariati, ka komunikuar me Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve të Maqedonisë nga i cili, kemi marrë përgjigje pozitive sa i përket huazimit të këtij produkti me qëllim të kthimit të tij kur ata do e kenë organizimin e zgjedhjeve vitin e ardhshëm, paralelisht me zgjedhjet lokale në Kosovë.

Përpos këtij aktiviteti të prokurimit, aktivitetet tjera janë në proces dhe besojë që javën tjetër do ta kemi një raport se në çfarë faze jemi, dhe a do t'i kemi të gjitha produktet. Mirëpo, nuk parashihet të kemi vështirësi sa i përket planit të prokurimit duke mos anashkaluar që, paralelisht jemi duket punuar edhe në planin e punës së vitit 2020, me qëllim që të gjitha këto aktivitete që janë paraparë të realizohen këtë vit.

Valdete Daka: Për korrektësi vetëm një korigjim të vogël: buxheti nuk është ndarë i ri por jepet ai që ka qenë për investime kapitale, pra mjetet na është lejuar t'i shpenzojmë për zgjedhje...

Alim Rama: Unë kam ngritur çështje para disa javë! Nuk e di a e keni nënshkruar atë emërimin për Burimin, mbasi që Burimi përfaqëson këtu Sekretariatin! Unë, dua ta di se a e përfaqësojnë në mënyrë legjitime dhe, këtë çështje kemi thënë që do e trajtojmë. Por, kanë kaluar dy javë dhe ende nuk e kemi trajtuar. E dyta, unë kisha këshilluar dhe sugjeruar se sa herë bëhet programi orientues për anëtarët e KQZ-së, të lajmrohen anëtarët e komisionit që të marrin pjesë sepse, është shumë domethënëse që anëtarët e KQZ-së t'i njoftojnë pasi ata, emërohen në mënyrë periodike, pra të japim mbështetje në kryerjen e punëve....

Arianit Elshani: E përmendët njëren nga pikat të programit orientues për anëtarë të komisionit komunal zgjedhor për Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut jam unë jam informuar për mbajtjen e takimit, siç jam informuar nga sekretariati ku kryeshefi dhe drejtoret e departamenteve paraqesin planin operacional para KKZ-vë. Në këtë rast, unë nuk jam ftuar por edhe anëtarët të tjerë nuk jemi ftuar në këtë takim dhe për mua, pjesëmarrja e anëtarëve të KKZ-ve në mënyrë të pa autorizuar në një farë formë në atë mbledhje, nuk ka korresponduar me faktin që nuk ka pasur një ftesë për të gjithë anëtarët. Andaj, e kam pa s'i një ndërhyrje në vetë sekretariatin e K!Z-së.

Pra, tha mw tej z. Elshani, është mirë që edhe Sekretariati të qëndroj i pavarur dhe mos të tentojmë që edhe ne anëtarët, të ndërhyjmë në të gjitha aktivitetet e sekretariatit meqë, edhe ata kanë përgjegjësi dhe kompetenca ligjore që u takojnë dhe i rregullojnë marrëdhëniet e punës mes tyre. Tjejtra: është puna që z. Alimi e përmendi lidhur me legjimitetin apo jo të kryeshefit...! Nuk është mirë të tentoj dikush që të përfitojë politikisht. Dihet se, kjo është në proces e sipër. Sa jam i informuar, ka ankesë. Pra, le të vazhdojnë t'i ndjekin procedurat...

Alim Rama: Sa i përket aktiviteteve të KKZ-ve, ato janë të emëruar prej KQZ-së, dhe nuk i ndalohet asnjë anëtar të KQZ-së që të marrë pjesë në aktivitete e KQZ-së, nëse veç informohet. Mbështetja e aktiviteteve, është e domosdoshme sa i përket legjimitetit. Sa i përket kryeshefit, puna është se unë jam për një proces ligjor dhe legjitim sipas procedurave të KQZ-së. Vendimi i KQZ-së ka thënë në pikën e dytë se "Sekretariati udhëzohet të përgatisë një akt emërimi sipas procedurave". Vendimi i dytë, unë mendoj që ka qenë në një mbledhje të uzurpuar të KQZ... Askush nuk është kundër procedurave por, ne duhet t'i respektojmë procedurat dhe unë, ende nuk jam i sigurt që zoti Ahmetaj është në mënyrë legjitime s'i kryeshef pasi procesi nuk ka përfunduar...

Eshref Vishi: Çështja e kryeshefit, ka kaluar në banalitet! Ju si kryetare, e keni sqaruar dhe nuk ka nevojë të kalohet prej një pike në pikën tjetër pa autorizime. Ndërsa sa u përket KKZ-ve, është aktivitet i Sekretariatit...

Alim Rama: Unë kam kërkuar nga Sekretariatit dokumentet – vendimet e panelit për ankesa. Kryeshefi bënë presion që ato të mos dorëzohen, por ato janë publike...

3. Aktivitetet e ZRPPC-së

Shqyrtimi i rekomandimit për certifikimin e kandidateve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së veriut, që do të mbahen më 29 nëntor 2020:

YII Buleshkaj: Shkurt për punën e kryer në ZRPP, na ka ardhur një aplikacion nga një shtëpi mediatike me 10 vëzhgues. Tani, jemi në kohët kur dorëzohen këto kërkesa. Janë konfirmuar listat e vëzhguesve për komunën e Podujevës nga aplikimet nga dy OJQ, nga organizata ndërkombëtare NDI dhe, nga RTK. Ne, do të procedojmë më tutje. Po ashtu, edhe organizata Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim me seli në Francë që i ka përcjellë zgjedhjet e kaluara, na ka shkruar se nëse nuk ka pengesa ose lehtësohen masat anti covid, janë të interesuar t'i vëzhgojnë zgjedhjet...

Subjektet politike, deri në fund të javës kanë kohë t'i konfirmojnë listat e tyre vëzhguese. Për vëzhgues shtesë, afati i fundit është deri më 21 nëntor, kurse për media dhe organizata është deri më 23 nëntorë...

Lidhur me aktivitetet e tjera, jeni njoftuar me kohë...! Në anën tjetër, subjektet politike që kanë konkurruar për certifikim, i kanë plotësuar kushtet. Prandaj, ne rekomandojmë që të certifikohen:

1. Serbska Lista – kandidati: Milan Radojeviq,
2. Kandidati i pavarur: Dushan Milanoviq,
3. PDK – kandidati: Florent Azemi,
4. Lëvizja VV-kandidati: Erden Atiq.

Radhitja, është bërë në bazë të kohës kur janë dorëzuar aplikimet. Lidhur me raportin diskutoi, analizoi dhe shtroi pyetje Arianit Elshani. Mandej, anëtarët e KQZ-së miratuan rekomandimet e zyrës, dhe certifikuan tre (3) kandidatë për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës, që do të mbahen më 29 nëntor 2020, mirëpo jo edhe z. Erden Atiq, kandidatë i VV-së për të cilin votuan vetëm shtatë (7) anëtarë të KQZ-së, nga tetë (8) anëtarë sa ishin të pranishëm në mbledhje.

Në kotenst, znj. Daka tha se do ta njoftojë subjektin por, ajo shtoi se në këtë rast kemi obligim ligjorë t'i certifikojmë ata që i plotësojnë kushtet ligjore. PZAP, do ta rikthej në votim. Ne, jemi këtu që ta respektojmë ligjin. Në të kundërtën, mendoj që duhet ta rishqyrtojmë çështjen...!

Mbas kërkesës së kryetares, u ri votua edhe njëherë dhe të njëjtit (kandidati i pavarur Dushan Milanoviq dhe kandidati i VV-së, Erden Atiq), u certifikuan.

4.Raporti i Këshillave të KQZ-së

1.Këshilli për Çështje ligjore:

Shqyrtimi i Udhëzimit për Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) dhe Këshillat e Vendvotimeve (KVV) të cilat merren me organizimin dhe me implementimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së veriut, që ditën e zgjedhjeve, me 29 nëntor 2020, t'i pranojë në vendvotim dokumentet e identifikimit të votuesve:

Arianit Elshani : Këshilli, ka shqyrtuar këtë udhëzim për Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) dhe Këshillat e Vendvotimeve (KVV) që do të merret me identifikimin e votuesve në vendvotim. Ky udhëzim, është miratuar edhe në zgjedhjet e kaluara që qenë ndërprerë në Podujevë, por edhe në zgjedhjet nacionale 2019. Andaj, s'i edhe për lehtësimin e punës dhe mbarëvajtjen e procesit, sipas kërkësës së Sekretariatit, ne rekomandojmë për miratim.

Valdete Daka: Mbi referencat e ligjit, dokumentet valide në vendvotim sipas këtij udhëzim janë: letërnjoftimi i vlefshëm i Republikës së Kosovës, pasaporta valide, dokumenti i udhëzimi, dhe leja e vlefshme e vozitjes. Ky udhëzim, është i obligueshëm dhe duhet të zbatohet. Në të kaluarën kemi pasur keqkuptime, mirëpo ne edhe njëherë po e marrim vendimin që të mos ketë më tej probleme. Unë, tha znj. Daka i bëjë thirrje MPB që, meqë ende mund të ketë qytetarë që bartin dokumente të UNMIK-ut që ka vite nuk janë të vlefshme dhe se askush nuk mund të votoj me to, t'i largojet... Ndoshta jo në këtë zgjedhje, por në zgjedhjet e tjera të ardhshme. E theksoj se, ka qytetarë të shumtë me këto dokumente, prandaj të largohen nga lista votuese këta qytetarë me dokumente të UNMIK-ut...

Alim Rama: I bashkëngjitëm kësaj kërkesë që MPB t'i largojet nga Lista e votimit ata persona që kanë dokumente të UNMIK-ut. Por, kam një shqetësim se MPB nuk është në gjendje ta bëjë këtë, dhe ne po hyjmë në një fazë kur qytetarët tani nuk janë në gjendje të marrin dokumente të reja. Dhe unë, kisha këkuar që të gjendet modusi, një zgjidhje e mesme që, i lejon ata persona që kanë bërë kërkesë për dokumente, ose që kanë letërnjoftim të vjetër...Sepse, këtu bëhet shtypja e votuesit...!

Në këtë pikë, analizuan dhe diskutuan: Valdete Daka, Sami Hamiti, Arianit Elshani. Në kontekst, znj. Daka tha se, ne ftojmë MPB-në që deri në ditën e zgjedhjeve, ata që kanë bërë kërkesë për dokumente që, t'u mundësohet marrja sa më shpejt e dokumenteve deri në ditën e zgjedhjeve, përndryshe është e pamundur, supozoj që ndonjë qytetarë të mos ketë asnjë dokument valid...

Valdete Daka: Atëherë, kush është për këtë udhëzim ?

Anëtarët e KQZ, me shtatë (7) vota për, dhe një abstenim (Alim Rama), u miratua ky udhëzim.

5.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1.Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Modernizimin e QNR-së:

Alim Rama: Fillimisht, mund të them se strategjia është kthyer tek Sekretariati, dhe tash i plotëson të gjitha kushtet! Nëse ka nevojë për informatë shtesë...! Mendoj që është në rregull, ndërsa Draft-Plani Operacional i Sigurisë i KQZ-së për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë dhe në Mitrovicë të Veriut, është përpëra jush. Pra, e keni draftin e punës...që, i merr në konsideratë rekomandimet e IKSHP-së, por ky plan në momentin e fundit kur mund t'i merr rekomandimet e reja të ISHQP-së, mund të ndryshohet...Mirëpo, tani i përmbrushë kushtet dhe, pak a shumë është i ngjashëm me planet e mëhershme zgjedhore...

Eshref Vishi: Mendoj që ky plan i sigurisë është mirë të futet në olanin e punës për vitin 2021, sepse ka nevojë të rishkruhet, dhe ka nevojë për një narrativë tjetër! Ka qenë i përfshirë s'i aktivitetet në plan të punës për këtë vit, i paraprë të realizohet në shtator/tetor. Nuk e di, kemi kërkuar edhe më 2017 të ndryshohet, mirëpo nuk e di pse nuk është ndryshuar...

Në fund, anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë Draft-Plan.

6. Shqyrtimi i kérkesës të Sekretariatit të KQZ-së, për furnizimin me (660) Uv Sprej nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë dhe Mitrovicën e Veriut, që do mbahen do të mbahen më 29.10.2020

Valdete Daka: Jemi të informuar mbi këtë çështje, dhe se nuk mendoj që kemi nevojë për debat, prandaj kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë kérkesë.

7. Raporti i Këshillit Mbikqyrës për Informim

Arianit Elshani: Këshilli në mbledhje ka shqyrtuar dhe miratuar tv-spotin, radiospotin dhe Gifin për editimin për periudhën e regjistrimit të personave me nevoja të veçanta për votim përmes ekipeve mobile; Për periudhën për votim përmes Postës; Për periudhën e ndërrimit të Qendrave të Votimit. Këto produkte, janë shpërndarë dhe pritet të publikohen qysh sot në ueb faqen e KQZ-së, në media, në rrjetet sociale, në rrjetet e OJQ-ve dhe, në institucionet e tjera relevante: në ueb faqet e komunave në Podujevë dhe në Mitrovicë, s'i dhe në hapësira ét tjera relevante...

8. Të dryshme.